



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 351-18308/19

Date 07.05.2019

KONTRATA PUBLIKE nr. 22-2019

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Nr Bisnesi 0700032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

Dhe

G.O.E. " AIM - shpk " ME SELI NE KLINE ,ne grup me Trasing Group nga Drenasi .Lider i projektit eshte i caktuar AIM SHPK nga Klina , KOMUNA E KLINES , ne tekstin e metejme kontraktuesei me numer biznesi 70476040, numer fiskal 600048137, me perfaqesues z. Artan ARBEN MALOKU .

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

ASFALTIMI I RRUGEVE :

LOT 1- ASFALTIMI I RRUGES BUDISALC

LOT 1- ASFALTIMI I RRUGES LOKALE NE STUP

me numër identifikues: 634-19-636-5-2-1/INT.634-19-011-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Detyrat e punës se punetoreve te angazhuar ne kete kontrate :

- Shërbimi duhet te jete profesional dhe sipas përshkrimit ne paramas ato duhet te jene fikse.

1.2 Lënda e kësaj kontrate publike është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Neni 2 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i punëve

NDËRTIMI ME ASFALT I RRUGËVE LOKALE BUDISALC PARAMASA DHE PARALLOGARIA

A PUNËT PËRGATITORE					
Po s	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi pa vsh	Gjithsej pa tvsh
A.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve sipas projektit. Të caktohen pikat gjeodezike të projektit nga ekzekutuesi i punimeve para fillimit të punimeve.	total	1.00	850.00	850.00
A.2	Shënimi i trases, bartja e elementeve nga projekti në teren.	m'	1 125.00	1.50	1.687.50
A.3	Pastrimi i terenit nga objektet ekzistuese në dy anet : Largimi i pengesave në rrugë si barishtave, shkurreve drunjeve etj.	m'	1 125.00	1.50	1.687.50

A.4	Punimi i bankinave në dy anet e rruges: Nivelizimi i tokës me saktësi 3cm, ngjeshja me vibro-cilinder $M_s=300\text{Kn/m}^2$, furnizimi me material vendor-rrethanor me përmbajtje gurore (fraksioni 0-31.5mm), që i përgjigjet kualitetit për bankina, transporti, planifikimi me trashësi 10cm në gjendje të ngjeshur, gjëresia e bankinës 0.50m.	m'	1125.00	0.35	393.75
A.5	Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujërave atmosferik në formë trapezi sipas detajit të dhënë në projekt.	m'	600.00	0.50	300.00
A.6	Egzaminimi i materialeve dhe bazes së rruges para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. Asfaltit, gurit dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përdhjen e	p.s.	1.00	85.00	85.00

materialit para fillimit
të punimeve.

Total Pozicioni A : 5.003.75

B

**PUNËT E DHEUT
(TOKËSORE)**

Po
s

Përshkrimi i pozicionit

Njësia

Sasia

Çmimi
pa tvsh

Gjithsej
Pa tvsh

B.1

Mihja e dheut në
gjerësi me makinë në
teren të kat. III dhe IV,
ngarkimi dhe
transporti deri në një
vend të caktuar ku e
cakton nga organi
mbikëqyres. Materiali i
gërmuar të përdoret
për mbushje edhe atë
sipas profileve në
projekt. Mbushja në
vendet e parapara të
behët me ngjeshje në
shtresa .

m³

1462.00

0.40

584.80

B.2

Planifikimi dhe
nivelizimi i nënbazës
sipas profileve në
projekt si dhe
ngjeshja e saj me
cilinder deri në masë
të kërkuar sipas
normave dhe
standardeve për këtë
lloj pune (Mt≥400
kg/cm²)

m²

4900.00

0.05

245.00

Total Pozicioni B : 829.40

C OBJEKTET					
Po s	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Punimi i bazës nga zhavori për vendosjen e shtresës së asfaltit dhe atë si vijon:				
C.2					
C.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-63 mm me trashësi të shtresës d=20cm në gjendje të ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ($M_t \geq 600 \text{ kg/cm}^2$). Gjithashtu duhet të behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca në mes matjeve sipas	m ³	976.00	2.60	2.537.60

	normave dhe standardeve.				
C.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-31,5 mm me trashësi të shtresës d=10cm në gjendje të ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune ($M_t \geq 800 \text{ kg/cm}^2$). Gjithashtu duhet të behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca në mes matjeve sipas normave dhe standardeve.	m ³	488.00	3.00	1.464.00
	Total Pozicioni C :				4.001.60
D	PJESA QARKULLUESE				
Po s	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
D. 1	Furnizimi, transporti shtruarja dhe ngjeshja e reres me trashesi 3 cm para shtruarjes së asfaltit.	m ³	115.00	3.50	402.50

0.2	Furnizimi, transporti, nivelizimi dhe shtrirja e shtresës nga asfaltbetoni AB 16 me trashësi të shtresës d=8cm ne gjendje te ngjeshur-kompaktesuar, ngjeshja me cilinder 12t sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	3770.00	5.50	20.735.00
Total Pozicioni D :					21.137.50

E PUNET E TJERA					
Po s	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
E.1	Ngritja e pusetave ne nivel me rrugen dhe vendosja e kapakeve prej gize me aftesi mbajttese 40t	copë	14.00	50.00	700.00
E.2	Punimi i lëshësave, pjeseve kaluese dhe kanaleve te mbyllura ne disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në çmim është llogaritur hapja e kanalit, furnizimi dhe vendosja e reres,				

	furinizimi dhe vendosja e gypit prej betoni të armuar me punim të baze dhe mbështjellësit prej betoni dhe i kokave hyrëse-dalëse, komplet për m'.				
	Ø 800 mm - me kokë hyrese-dalese (dy rende)	m'	10.00	25.00	250.00
	Ø 600 mm - me kokë hyrese-dalese	m'	10.00	25.00	250.00
E.3	Pastrimi i terenit pas perfundimit te gjitha punimeve	m'	1125.00	0.05	56.25
Total Pozicioni D :					1.256.25

REKAPITULIMI		
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Gjithsej
A	PUNËT PËRGATITORE	5.003.75
B	PUNËT E DHEUT (TOKËSORE)	829.40
C	OBJEKTET ME TAMPON	4.002.60
D	PJESA QARKULLUESE	21.13750
E	PUNET E TJERA	1.256.25
	Totali pa TVSH	32.228.90
	TVSH 18 %	5.801.20
TOTALI me tvsh		38.030.10

NDËRTIMI ME ASFALT I RRUGËVE LOKALE STUPE

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

A PUNËT PËRGATITORE					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi pa tvsh	Gjithsej pa tvsh
A.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve sipas projektit. Të caktohen pikat gjeodezike të projektit nga ekzekutuesi i punimeve para fillimit të punimeve.	total	1.00	1.600.00	1.600.00
A.2	Shënimi i trases, bartja e elementeve nga projekti në teren.	m'	1166.00	1.00	1.166.00
A.3	Pastrimi i terenit nga objektet ekzistuese në dy anet : Largimi i pengesave në rrugë si barishtave, shkurreve drunjeve etj.	m'	1166.00	1.00	1.166.00

A.4	Punimi i bankinave në dy anet e rruges: Nivelizimi i tokës me saktësi 3cm, ngjeshja me vibro-cilinder $M_s=300\text{Kn/m}^2$, furnizimi me material vendor-rrethanor me përmbajtje gurore (fraksioni 0-31.5mm), që i përgjigjet kualitetit për bankina, transporti, planifikimi me trashësi 10cm në gjendje të ngjeshur, gjëresia e bankinës 0.50m.	m'	1166.00	0.35	408.10
A.5	Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujërave atmosferik në formë trapezi sipas detajit të dhënë në projekt.	m'	500.00	0.50	250.00

A.6	Egzaminimi i materialeve dhe bazes se rruges para dhe pas vuarjës në vepër të tyre si psh. Asfaltit , gurit dhe elementeve tjera per shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përdardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	p.s.	1.00	100.00	100.00
Total Pozicioni A :					4.690.10

B	PUNËT E DHEUT (TOKËSORE)				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
B.1	Mihja e dheut në gjerësi me makinë në teren të kat. III dhe IV, ngarkimi dhe transporti deri në një vend te caktuar ku e cakton nga organi mbikëqyres. Materiali i gërmuar te përdoret për mbushje edhe atë sipas profileve ne projekt. Mbushja në	m ³	1738.00	0.80	1.390.40

	vendet e parapara të behët me ngjeshje në shtresa .				
B.2	Planifikimi dhe nivelizimi I nenbases sipas profileve ne projekt si dhe ngjeshja e saj me cilindër deri ne masë të kërkuar sipas normave dhe standardeve për këtë lloj pune (Mt≥400 kg/cm²)	m²	5794.00	0.10	579.40
Total Pozicioni B :					1.969.80

C	OBJEKTET				
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
	Punimi i bazës nga zhavori për vendosjen e shtresës së asfaltit dhe atë si vijon:				
C.2					
C.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-63 mm me trashësi të shtresës d=20cm ne gjendje te ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune	m³	1,158.00	2.80	3.242.50

	(Mt≥600 kg/cm ²). Gjithashtu duhet te behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca ne mes matjeve sipas normave dhe standardeve.				
C.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-31,5 mm me trashësi të shtresës d=10cm ne gjendje te ngjeshur, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt≥800 kg/cm ²). Gjithashtu duhet te behen matjet gjeomekanike nga kompani e licencuar për matje. Distanca ne mes matjeve sipas normave dhe standardeve.	m ³	580.00	3.00	1.740.00
	Total Pozicioni C :				4.98.40

D PJESA QARKULLUESE					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
D.1	Furnizimi, transporti shtruarja dhe ngjeshja e reres me trashesi 3cm para shtruarjes se asfaltit	m ³	140.00	3.00	420.00
0.2	Furnizimi, transporti, nivelizimi dhe shtrirja e shtresës nga asfaltbetoni AB 16 me trashësi të shtresës d=8cm ne gjendje te ngjeshur-kompaktesuar, ngjeshja me cilinder 12t sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	4638.00	5.00	23.190.00
Total Pozicioni D :					23.610.00

E PUNET E TJERA					
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
E.1	Ngritja e pusetave ne nivel me rrugen dhe vendosja e kapakeve prej gize me aftesi mbajttese 40 ton	Cope	22	55.00	1210.00
E.2	Pastrimi I terenit pas perfundimit te gjitha punimeve	m'	1166.00	0.10	116.60
Total Pozicioni D :					1.326.60

REKAPITULIMI		
Pos	Përshkrimi i pozicionit	Gjithsej
A	PUNËT PËRGATITORE	4.690.10
B	PUNËT E DHEUT (TOKËSORE)	1.969.80
C	OBJEKTET ME TAMPON	4.980.40
D	PJESA QARKULLUESE	23.610.00
E	PUNET E TJERA	1.326.60
	Totali pa TVSH	36.578.90
	TVSH 18 %	6.584.20
TOTALI me tvsh		43.163.10

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike.

Neni 3 Koha e përfundimit

3.1 Plani Dinamik për kryerje të punëve është 60 ditë punë
(Rruga Budisalc - 25 ditë ,Rruga Stup 35 ditë

Vendi i kryerjes Punëve do të jetë në rrugët lokale sipas Kërkesës së urdheredhemesit nga Komuna , perkatesisht nga Menaxheri i Kontrates.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i punëve

Vlera Totale e Kontrates eshte

1. Rruga Budisalc 38.030.10€

(Tridhjetetetemijeetridhjeteeuroe10//100)

2. Rruga Stup 43.163.10 €

(Dyzetetreijeneqindegjashetdhjetetreeuroe10/100)

Totali = 81.193.20 € (Teteedhjetenjemijenjeqindenenedhjetetreeuroe20/100)

4.3. Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës. Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te shërbimeve ne periudha mujore , Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

4.4.Me situacione ne vlere mbi punet e përfunduara .

4.5.Mbajtje te Paras ne vlere 10 % nga Vlera e kontrates do te paguhet pas Afatit te Garancionit te punimeve prej 12 muajeve pas pranimit te perkoheshem teknik

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 7. Menaxhimi i Kontrates

7.1. Menaxher i projektit është : z.Lorenc Marleku nga Njesia Kerkuese .

7.2..Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____

7.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA KLINE

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	07.05.2019
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve :

AIM SHPK – KLINE

Emri:	ARBEN MALOKU –
Pozita:	I AUTORIZUAR
Nënshkrimi:	
Data:	07.05.19
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjesë të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjesë të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë mëdhe siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rreshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të menjauar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorur është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykim i forcës së *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhrat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë

autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë

të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik;

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik;

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emer të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik;

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes së kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>Lorenc Marleku – DREJTORIA E Urbanizmit</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % vlerës së Plafikuar të kontratës, PERKATESISHTE VLERA 8.119.32 € ME AFATE 100+30=130 dite
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës b) Përgjegjësia e palës së tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës d) Përgjegjësia profesionale 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është gjatë kohës së Validitetit të Kontratës. <u>Per Cilesi duhet te Sillen Ateste per Zhavor, Asfalt dhe Bitumen.</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do të përpiqet që me pajtueshmëri të dy palëve të zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>Gjykata Themelore Peje – Dega Kline</u> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregut, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregut Ndërkombëtar, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

EMËRTIMI I MENAXHERIT TE PROJEKTIT

"AIM" SH.P.K I përfaqësuar nga z. Arton Maloku –Drejtor ligjor,
"Trasing Group" SH.P.K I përfaqësuar nga z. Visar Berisha–Drejtor ligjor

Emërtojmë menaxherin e projektit në fjalë ing. Dipl. Ndërt. **Agim Gjoshi**

Titulli i ptojektit: ASFALTIM I RRUGEVE, LOT 1- RRUGEVE LOKALE NE BUDISALC, LOT 2- RRUGEVE LOKALE STUP, LOT 3- RRUGEVE LOKALE NE SIQEVE, LOT 4- RRUGEVE LOKALE QESKOVE, LOT 5- RRUGEVE LOKALE GJURGJEVIK I VOGEL

Nr. I Prokurimit: 634-19-636-5-2-1, me nr te brendshem 634-19-011-521.
(dokumentat e tij :CV,Diploma ,kontrata e punës si dhe dokumentacioni përkatës gjinden në dosjen e Bashkangjitur,).
Injiniieri I lartëpermendur do ti udhëheqë punimet sipë projektit dhe kontratës së mundshme në emër të konzerciumit:

KOMPANIA :

PËRFAQËSUESI :

NËNSHKRIMI:

VULA:

1. AIM Sh.p.k.

Arton Maloku

2. TRASING GROUP SH.P.K

Visar Berisha



Më datën 26.03.2019

Kline



"AIM"

sh.p.k.

Adresa :
Rr. Abedin Rexha
NRB: 7068
NRF: 600517835
Tel: 039 470 761
Mob: 044720177
Klinë - Kosovë



		ASFALTIM I RRUGEVE								LOT 1- RRUGEVE LOKALE NE BUDISALC															
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
1	A.1 Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve sipas projektit. Të caktohen pikat gjeodezike të projektit nga ekzekutuesi i punimeve para fillimit të punimeve.																								
2	A.2 Shërimi i rrugës, bartja e elementeve nga projekti në terren.																								
3	A.3 Përfundimi i termit nga objekti ekzistues në dy anet. Largimi i pengesave në rrugë si barshtrave, shkurreve drunjtore etj.																								
4	A.4 Punimi i bankinave në dy anet e rrugës. Nivelizimi i tokës me saktësi 3cm, ngjeshja me vbro-cilinder $M_s=300Kn\ m^2$, turizimi me material vendor-rethanor me përmbajtje gurorë (fraksion 0-31.5mm), që i përgjigjet kualitetit për bankidra, transport, planifikimi me trashësi 10cm në gjendje të ngjeshur, gjërësia e bankinës 0.50m.																								
5	A.5 Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujërave atmosferik në formë trapezi sipas detajit të dhënë në projekt.																								
6	A.6 Egzaminimi i materialeve dhe bazës së rrugës para dhe pas vërës në vepër të tyre si psh. Astaltit, gurt dhe elementeve tjera për shqyrtim. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe përfundim të materialit para fillimit të punimeve.																								

1000 • Dondur

